



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
DREJTORIA E TARIFAVE DHE ÇMIMEVE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.10.2025

RELACION

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR  
KARIKIMIN E MAKINAVE ELEKTRIKE NË PIKAT/STACIONET E KARIKIMIT  
ME FUQI TË INSTALUAR MBI 11 KW**

**Të nderuar anëtarë të Bordit.**


FSHU sh.a. me shkresën nr. 5199 prot., të datës 03.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2586 prot., datë 06.10.2025, ka depozituar në ERE “Kërkesën për rivlerësim të të ardhurave të FSHU sh.a. dhe çmim të diferencuar të shitjes së energjisë elektrike për karikim makinash”.

Në kërkesën e sipërcituar, shoqëria FSHU sh.a. bën me dije struktura e konsumit të energjisë gjatë periudhës 8-mujore të vitit 2025, ka pësuar ndryshime të rëndësishme në drejtim të rritjes së energjisë së konsumuar për karikimin e makinave elektrike, përdorimi i të cilave po rritet me shpejtësi, duke sjellë nevojën e krijimit të një kategorie të re konsumatore, nisur dhe nga fakti se numri i makinave të regjistruara sipas publikimeve zyrtare të DPSHRT vijon të ketë një rritje të shpejtë nga viti në vit dhe pritet të jetë i tillë edhe për periudhat në vazhdim.

Sa parashtruar nga FSHU evidentohet dhe nga raportet e publikuar në faqen zyrtare të DPSHTR, ku numri i makinave elektrike të regjistruara në vendin tonë deri në maj 2025 ka qenë 8,043. Krahasuar me numrin e makinave të regjistruara përgjatë vitit 2024 prej 6,378, evidentohet se për 5 muajt e parë të vitit numri i tyre është rritur me 26%. Trendi i rritjes së numrit të makinave elektrike të regjistruara ndër vite në Shqipëri paraqitet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Viti	Flota e mjeteve all electric aktive	Trendi i ndryshimit
2019	175	
2020	493	182%
2021	861	75%
2022	1,535	78%
2023	3,321	116%
2024	6,378	92%
2025 (janar-maj)	8,043	26%

## FLOTA E MJETEVE ALL ELECTRIC



Burimi: Faqja elektronike zyrtare e DPSHTRR, URL: <https://www.dpshttr.al/statistika-green> ; datë 10.10.2025;

FSHU sqaron se bazuar në të dhënat e treguesve teknik dhe të konsumit specifik të secilës kategori konsumatorësh, në fillimet e instalimit të këtyre stacioneve/pikave të karikimit, impakti i tyre në kostot e furnizimit nga FSHU sh.a. ka qenë në nivele të pakonsiderueshme. Ndërkohë që për shkak të rritjes së ndjeshme gjatë vitit 2025 të numrit të makinave elektrike dhe stacioneve të karikimit, konsumi i tyre krahasuar me periudhat e mëparshme ka ardhur në rritje progresive.

Shoqëria bën me dije se, nga analiza e treguesve financiarë faktik të vitit 2024, krahasuar me planifikimin e tyre për të njëjtën periudhë rezulton se të gjithë komponentët kanë ruajtur të njëjtin trend sikurse të dhënat historike të këtyre zërave. Sipas FSHU sh.a., për vitin 2024 shoqëria ka arritur të kryej nominime më të sakta nisur nga historiku i konsumit sipas kategorive të klienteve duke arritur të ulë koston e disbalancave të shkaktuar nga ndryshimet e energjisë së furnizuar/konsumuar nga ajo e nominuar sipas programeve respektive.

Ndërkohë për vitin 2025, bazuar në të dhënat faktike të treguesve financiarë të tetë-mujorit, FSHU konstaton se ndërkohë që kostot e transmetimi, shpërndarjes dhe blerjes së energjisë kanë vijuar të ruajnë trendin e periudhës së mëparshme ushtrimore, vërehet se zëri kosto e disbalancave ka pësuar një rritje të konsiderueshme, ku nga sa planifikuar nga shoqëria në vlerën 430 milion lekë, rezulton se realizimi për tetë-mujorin e parë është 552 milion lekë.

FSHU sh.a. sqaron se, rritja e këtij shpenzimi ka ardhur kryesisht si rrjedhojë e rritjes së konsumit të energjisë nga pikat/stacionet e karikimit të makinave elektrike me fuqi të instaluar mbi 11kW. Për rrjedhojë bëhet e nevojshme që kosto e shtuar e disbalancave të shkaktuara, të rikuperohet nëpërmjet alokimit të këtij shpenzimi për njësi konsumi të furnizuar, pikat/stacionet e karikimit të makinave elektrike me fuqi të instaluar mbi 11kW.

**Sa më sipër, FSHU kërkon të recuperojë kostot që priten të shkaktohen në vijim nga kjo kategori konsumatorësh nëpërmjet çmimit të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave prej 22 lekë/kWh prej datës 1 Nëntor 2025 e në vijim duke mos ndryshuar çmimet aktuale të shitjes së energjisë elektrike në fuqi për kategoritë ekzistuese të konsumatorëve të lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV, të cilët furnizohen prej shërbimit universal.**

Bazuar në aplikimet e kryera në OSSH nga abonentë familjarë dhe jofamiljarë për shtesë fuqie apo pikë lidhje të re deri në një fuqi 11 kW për qëllime karikimi, propozohet që:

- **Çmimi prej 22 Lekë/kwh të aplikohet për të gjithë abonentët familjarë dhe jofamiljarë me kapacitet të instaluar mbi 11 kW të cilët mund të shfrytëzojnë kapacitetin e lejuar për karikim mjetesësh elektrike;**
- **Për abonentët me fuqi të instaluar deri në 11 kW do të aplikohen çmimet respektive në fuqi.**

Bashkëlidhur kësaj kërkesë shoqëria ka paraqitur treguesit kryesorë të performancës për periudhën Janar-Gusht 2025 ( të realizuara krahasuar me atë të planifikuar sipas planit të vitit 2025 si vijon:

000/Lekë	Përshkrimi	Viti 2025 Janar-Gusht Fakt	Viti 2025 Janar-Gusht Plan	Diferenca (Fakt-Plan)	%
<b>Të Ardhurat</b>	Të ardhura nga Shitja e energjisë	42,247,043	39,221,556	↑ 3,025,487	108%
	Të ardhur nga kamatëvonesat	591,889	680,627	↓ (88,738)	87%
	Të tjera	299,221	299,221	↑ -	100%
	<b>Gjithsej</b>	<b>43,138,153</b>	<b>40,201,404</b>	<b>↑ 2,936,749</b>	<b>107%</b>
<b>Shpenzimet</b>	Shpenzime Energji e Blerë	11,295,689	10,398,907	↓ 896,782	109%
	Tarifa e Shpërndarjes dhe Ener. Reak.	24,030,193	22,572,598	↓ 1,457,595	106%
	Transmetim, Disbalanca dhe Mimb.	4,296,509	3,939,623	↓ 356,886	109%
	Shpenzime Operative	2,036,721	2,138,610	↑ (101,888)	95%
	Provizione	431,991	431,991	↓ -	100%
	<b>EBITDA</b>	<b>1,047,050</b>	<b>719,676</b>	<b>↑ 327,374</b>	<b>145%</b>
	Amortizimi	108,731	108,731	↓ -	100%
	Shpenzime Financiare	448,888	448,888	↓ -	100%
	Tatim Fitimi	183,349	91,359	↓ 91,990	201%
	<b>Gjithsej</b>	<b>42,832,071</b>	<b>40,130,707</b>	<b>↓ 2,701,364</b>	<b>107%</b>
<b>REZULTATI FINANCIAR</b>		<b>306,082</b>	<b>70,697</b>	<b>↑ 235,384</b>	
<b>Energji e Shitur</b>		<b>3,839,218</b>	<b>3,593,323</b>	<b>↑ 245,895</b>	<b>↑106.8%</b>

**Si dhe Pasqyrën e Performancës Financiare, me zërat të ndara në mënyrë analitike, të realizuar për tetë-mujorin 2025 krahas planit të FSHU sh.a. për të njëjtën periudhë:**

FSHU PASH (000 / ALL)	Janar - Gusht 2025	Janar - Gusht 2025	GUSHT	
	FSHU	Plani FSHU	Diferencë	%
<b>TË ARDHURA</b>	43,138,153	40,201,404	2,936,749	107%
Të adhura nga SHITJA	42,838,932	39,902,183	2,936,749	107.4%
Të Ardhura të Tjera	95,214	299,221	(204,006)	32%
Të Ardhura nga shërbime korporative	204,006	-	204,006	
<b>SHPENZIMET</b>	(42,199,834)	(39,590,460)	(2,609,374)	107%
Shpenzime Energjie	(39,622,391)	(36,911,128)	(2,711,263)	107%
<i>Energji e Blerë</i>	(11,295,689)	(10,398,907)	(896,782)	109%
Tarifa e Shpërndarjes	(23,825,462)	(22,355,340)	(1,470,122)	106.6%
Energji Reaktive	(204,731)	(217,258)	12,527	94%
Tarifa e Transmetimit	(3,263,335)	(3,054,325)	(209,010)	107%
Disbalancat	(552,045)	(430,583)	(121,462)	128%
<i>Tarifë e mirëmbajtjes "0/kwh" FSHU</i>	(481,129)	(454,716)	(26,413)	106%
Marzhi Bruto	2,624,652	2,310,428	314,224	114%
Marzhi Bruto %	6.2%	5.9%	0.3%	105%
Shpenzime Operative	(2,036,721)	(2,138,610)	101,888	95%
Dëmtime dhe Provigjone	(431,991)	(431,991)	-	100%
EBITDA	1,047,050	719,676	327,374	145%
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(108,731)	(108,731)	-	100%
Fitim / Humbje Operative (EBIT)	938,319	610,944	327,374	154%
Shpenzime Financiare - neto	(448,888)	(448,888)	-	100%
Fitim / Humbja përpara Taksave	489,431	162,056	327,374	302%
Shpenzime Tatim Fitimi	(183,349)	(91,359)	(91,990)	201%
Fitim / Humbja e Periudhës	306,082	70,697	235,384	433%

FSHU argumenton se zërat: kosto e blerjes së energjisë, kosto e transmetimit dhe kosto e shpërndarjes janë të pandryshueshme, për arsye se çmimi i blerjes së energjisë, tarifa e transmetimit dhe shpërndarjes janë tarifa konstante. Për rrjedhojë dhe ndryshimet në vlerë të shpenzimeve për këta komponentë të të ardhurave të kërkuara rriten në proporcion të drejtë me rritjen e sasisë së konsumit.

FSHU sh.a. vlerëson se, në mungesë të historikut të konsumit të kategorisë pika/stacione karikimi, nuk mund të realizohen programe për mbulimin e kërkesës për energji të përafërta me konsumin faktik.

Në vijim FSHU sh.a. sqaron se shërbimi i furnizimit për karikim të makinave rrit koston e disbalancave për shkaqe që lidhen me teknologjinë e karikimit si:

- Koha e karikimit varet nga kapaciteti i baterisë dhe vlera e ulët e fuqisë së saj në periudhën e vendosjes në karikim, prandaj edhe koha e qëndrimit dhe sasia e enegjisë që do të përdoret është vështirë të parashikohet duke rritur disbalancat.
- Përdorimi i kapacitetit të instaluar është i lartë në periudhën e parë të karikimit me fuqi dhe konsum të madh energjie dhe i ulët në pjesën e fundit të saj duke ulur probabilitetin e saktësisë së parashikimit që ndikon në rritjen e disbalancave.
- Parashikimet e energjisë së haxhuar vështirësohen më tej në rastet e pikave të karikimit me më shumë se një automjet duke rritur më tej koston e disbalancave.

FSHU sh.a., mbështetur në vlerësimet e mësipërme, ka përlogaritur çmimin e shitjes së energjisë elektrike prej 22 Lekë/kWh, nga aplikimi i së cilit shoqëria parashikon që për vitin 2026 të realizojë një shtesë neto në të ardhurat prej rreth 245 milion Lekë, të cilat do të mbulojnë kostot që priten të shkaktohen në vijim nga kjo kategori konsumatore. Shoqëria deklaron se çmimi i shitjes së energjisë elektrike për pikat/stacionet e karimikimit të makinave elektrike nuk do të ketë efekt në performancën financiare të FSHU për vitin 2026, që sipas parashikimeve të saj do të vijojë të mbetet pozitive dhe me një fitim minimal.

Në përfundim, FSHU sh.a. kërkon shqyrtimin e përsheptuar të kësaj kërkesë duke patur parasysh zhvillimin e vullshëm të këtij aktiviteti në tregun e energjisë, i cili është pjesë e zhvillimeve prioritare sipas Programit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe nevojën e ngutshme të mbulimit të kostove që krijohen për aktivitetin e FSHU.

### **Vlerësimet e ERE në lidhje me kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a. për rivlerësimin e të Ardhurave dhe çmimit propozuar të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike.**

Bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal FSHU”, çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët sipas nivelit të tensionit ku janë lidhur duhet të reflektojnë plotësisht kostot që ato shkaktojnë për marrjen e shërbimit të furnizimit me energji elektrike, të jenë transparente dhe jo-diskriminuese.

Në zbatim të sa më sipër, ERE në fillim të vitit 2025 kreu analizat dhe vlerësimet e saj mbi nivelin e të ardhurave të kërkuara dhe çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, mbi të cilat u mbështet dhe vendimi i bordit të ERE-s nr. 10, datë 08.01.2025.

Të ardhurat e kërkuara të FSHU sh.a të vlerësuara nga ERE kanë marrë në konsideratë që kosto e blerjes së energjisë elektrike, që do të shërbejë për mbulimin e kërkesës për energji për klientët, të cilët shërbehen në kushtet e shërbimit universal të furnizimit, do të jetë a pandryshueshme ashtu sikurse dhe tarifat të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike. Ndërkohë që, për kostot e disbalancave për vitin 2025, është konsideruar vlera e parashikuar dhe paraqitur prej FSHU sh.a., e cila është mbështetur në të dhënat paraprake të vitit 2024. Megjithatë, kjo kosto është dinamike dhe afektohet nga disa faktorë teknik dhe ekonomik, të cilët nuk janë të parashikueshëm përgjatë një periudhe kohore të caktuar.

FSHU sh.a. duhet t’i përmbahet realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve brenda parashikimeve të komponentëve të të ardhurave të kërkuara të vitit 2025, mbi të cilat është mbështetur dhe vendimi i bordit të ERE-s në fuqi. Në këto kushte, shoqëria duhet të jetë e kujdesshme në realizimin e shpenzimeve të cilat mbuloohen prej të ardhurave nga shitja e energjisë elektrike konform strukturës së çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për kategori

konsumatore të miratuara nga ERE, por dhe duhet të identifikojë çdo shpenzimi tjetër të krijuar përtej parashikimeve, që mund të afektojë aktivitetin e saj ekonomik dhe financiar.

Vlersojmë se kërkesa e depozituar në ERE prej FSHU sh.a., nuk përmban elementët e një aplikim për përcaktimin apo rishikimin e cmimeve të shitjes së energjisë elektrike me pakicë për konsumatorët që shërbehen në kushtet e shërbimit universal të furnizimit, por evidenton në nevojën për kategorizimin e një grupi të ri konsumator dhe përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, përmes të cilit të ardhurat që do të krijohen do të shërbejnë për mbulimin e kostove të shkaktuara nga kjo kategori në periudhën në vazhdim.

### Treguesit e performancës financiare të FSHU sh.a. për periudhën Janar- Gusht

FSHU PASH (000 / ALL)	Janar - Gusht 2025	Janar - Gusht 2025		GUSHT
	FSHU	Plani FSHU	Diferencë	%
<b>TË ARDHURA</b>	43,138,153	40,201,404	2,936,749	107%
Të adhura nga SHITJA	42,838,932	39,902,183	2,936,749	107.4%
Të Ardhura të Tjera	95,214	299,221	(204,006)	32%
Të Ardhura nga shërbime korporative	204,006	-	204,006	
<b>SHPENZIMET</b>	(42,199,834)	(39,590,460)	(2,609,374)	107%
Shpenzime Energjie	(39,622,391)	(36,911,128)	(2,711,263)	107%
<i>Energji e Blerë</i>	(11,295,689)	(10,398,907)	(896,782)	109%
Tarifa e Shpërndarjes	(23,825,462)	(22,355,340)	(1,470,122)	106.6%
Energji Reaktive	(204,731)	(217,258)	12,527	94%
Tarifa e Transmetimit	(3,263,335)	(3,054,325)	(209,010)	107%
Disbalancat	(552,045)	(430,583)	(121,462)	128%
<i>Tarifë e mirëmbajtjes "0/kwh" FSHU</i>	(481,129)	(454,716)	(26,413)	106%
Marzhi Bruto	2,624,652	2,310,428	314,224	114%
Marzhi Bruto %	6.2%	5.9%	0.3%	105%
Shpenzime Operative	(2,036,721)	(2,138,610)	101,888	95%
Dëmtime dhe Provigjone	(431,991)	(431,991)	-	100%
EBITDA	1,047,050	719,676	327,374	145%
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(108,731)	(108,731)	-	100%
Fitim / Humbje Operative (EBIT)	938,319	610,944	327,374	154%
Shpenzime Financiare - neto	(448,888)	(448,888)	-	100%
Fitim / Humbja përpara Taksave	489,431	162,056	327,374	302%
Shpenzime Tatim Fitimi	(183,349)	(91,359)	(91,990)	201%
<b>Fitim / Humbja e Periudhës</b>	<b>306,082</b>	<b>70,697</b>	<b>235,384</b>	<b>433%</b>

Sa konstatohet nga zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve, FSHU sh.a. për periudhën tetë mujore ka patur një performancë financiare pozitive, ku zërat si: kosto e blerjes së energjisë, kosto e tarifave të rrjeteve, janë mbuluar nga të ardhurat e realizuara nga shitja e energjisë elektrike. Aktiviteti i shoqërisë për tetë-mujorin 2025 rezulton me një fitim prej 306 milion lekë.

Nga analiza e treguesve të performancës financiare të FSHU sh.a. për periudhën tetë-mujore, konstatohet se realizimi faktik i të ardhurave dhe shpenzimeve krahasuar me planifikimi për të

njëjtën periudhë ka qenë pothuajse në të njëjtin nivel. Shoqëria sqaron ndër të tjera se Fitimi prej 306 milion lekë është realizuar si rezultat i:

- të ardhurave shtesë në muajin janar prej 442 milion Lekë më shumë se ato të planifikuara për shkak të aplikimit me 1 shkurt 2025 të çmimeve shitjes për klientët familjarë;
- rritjes së të ardhurave nga shitja e energjisë si rezultat i rritjes së konsumit ;
- uljes së shpenzimeve operative administrative

Ndërkohë konstatohet se e vetmja kosto që ka tejkaluar në një masë domethënëse parashikimin është kosto e disbalancave, e cila është realizuar në vlerën 552 milion lekë ose 28% mbi planifikimin e shoqërisë prej 430 milion lekë për periudhën në fjalë .

Shoqëria argumenton se, nga analizat e kryera realizimi i këtij shpenzimi, mbi vlerat e parashikuara është i lidhur me rritjen e konsumit të energjisë nga pikat/stacionet e karikimit të makinave elektrike. Duke qënë se rritja e konsumit nga pikat/stacionet e karikimit të makinave është progresive sipas publikimeve zyrtare të DPSHTRR (Faqja elektronike zyrtare e DPSHTRR, URL: <https://www.dpshttr.al/statistika-green> ; datë 10.10.2025;) , bëhet e nevojshme që këto kosto të rikuperohen duke alokuar këtë shpenzim për njësi konsumi të furnizuar me qëllim mbulimin e kërkesës për energji për pikat/stacionet e karikimit të makinave elektrike.

Referuar të dhënave të depozituara në ERE nga OSHEE sh.a.publikuara nga ERE (Raportet Vjetor për periudhat 2023 dhe 2024) rezulton se gjatë vitit 2023 janë instaluar 26 pika të reja për njësi të karikimit të makinave elektrike, respektivisht në Durrës 2 me fuqi të instaluar 250 kW, dhe në Tiranë 24 kontrata me fuqi të instaluar 2,565 kW.Ndërkohë në vitin 2024 janë instaluar për herë të parë 63 njësi karikimi. Deri në fund të vitit 2024 shpërndarja e stacioneve të karikimit rezultonte si më poshtë:

- Tiranë në total 119 kontrata për stacione karikimi, me fuqi të instaluar totale prej 19,383 kW;
- Durrës 10 kontrata për stacione karikimi me fuqi të instaluar prej 1,046 kW, ;
- Shkodër 9 kontrata për stacione karikimi me fuqi të instaluar prej 464 kW;
- Elbasan 8 kontrata për stacione karikimi me fuqi të instaluar prej 1,505 kW,;
- Gjirokastrë 7 kontrata për stacione karikimi me fuqi të instaluar prej 709 kW;
- Burrel 6 kontrata për stacione karikimi me fuqi të instaluar prej 645 kW;
- Berat 5 kontrata për stacione karikimi me fuqi të instaluar prej 1,060 kW,;
- Fier 5 kontrata për stacione karikimi me fuqi të instaluar prej 701 kW;
- Korçë 5 kontrata për stacione karikimi me fuqi të instaluar 398 kW;
- Vlorë 4 kontrata për stacione karikimi me fuqi të instaluar prej 716 kW.

Në total në Republikën e Shqipërisë deri në fund të vitit 2024 janë regjistruar gjithsej 178 kontrata për stacione karikimi me një fuqi të instaluar totale prej 26,627 kW, me një fuqi

mesatare të instaluar për stacion/pikë karikimi prej 146 kW. Referuar të dhënave të mësipërme, evidentohet se nëse në vitin 2020 ka pasur 41 stacione karikimi për 467 makina elektrike, në 2025 numërohen 254 pika karikimi për 8,043 automjete elektrike (të regjistruara deri në Maj 2025). Në këtë mënyrë raporti i ngarkesës së numrit të makinave për stacion/pikë karikimi nga viti 2020 deri më 2025 është rritur ndjeshëm.

Sikurse evidentohet më lart, përqëndrimi i stacioneve/pikave të karikimit është në qendrat urbane më të mëdha të vendit.

FSHU sh.a. sqaron se nga aspekti teknik, furnizimi i makinave elektrike kryhet nëpërmjet pikave/stacioneve të karikimi, të cilat kanë fuqi të instaluar në bazë të përdorimit pikave/stacioneve. Konsumatorët familjar apo jo familjar të cilët përdorin tipologji karikuesish slow charge (AC) për qëllime të karikimit të një makine elektrike për përdorim vetjak kërkojnë një shtesë fuqie apo pikë lidhje të re deri në një fuqi prej 11 kW, kjo bazuar edhe në kapacitet aktual të karikimit në AC të makinave elektrike. Ndërkohë, për pikat/stacionet të cilat karikojnë pa ndërpreje me fast charge (DC) mbi një makine elektrike njëkohësisht kërkojnë një fuqi të instaluar shumë herë më të madhe.

Për vlersimin e sa më sipër, janë marrë në konsideratë studimet e IEA (2024), ENTSO-E (2021, 2023) dhe NREL (2020), të aksesueshme në faqet si më poshtë:

- International Energy Agency (2025); “Global EV Outlook 2025”; URL: <https://iea.blob.core.windows.net/assets/0aa4762f-c1cb-4495-987a-25945d6de5e8/GlobalEVOutlook2025.pdf>;  
<https://docs.nrel.gov/docs/fy25osti/92396.pdf>;
- NREL. (2024); “Integrating Electric Vehicles into the Grid”; URL:
- ENTSO-E. (2021); “Electric Vehicle Integration into power grid”; URL: [https://eepublicdownloads.entsoe.eu/clean-documents/Publications/Position%20papers%20and%20reports/210331\\_Electric\\_Vehicles\\_integration.pdf](https://eepublicdownloads.entsoe.eu/clean-documents/Publications/Position%20papers%20and%20reports/210331_Electric_Vehicles_integration.pdf);
- NREL. (2020); “Grid Impact Analysis of Heavy-Duty Electric Vehicle Charging Stations”; URL: <https://docs.nrel.gov/docs/fy20osti/74838.pdf>;

Këto publikime tregojnë se karikimi i shpejtë, sidomos DC fast/ultra-fast, mund të shkaktojë devijime të tensionit, ngarkesa termike në transformatorë dhe “hotspots” të ngarkesës në nivelet TU/TM të rrjetit. Përqëndrimi i stacioneve në zona urbane, karikimi në orët e pikut, rrit disbalancat në rrjet. ENTSO-E (2021) thekson se integrimi masiv i EV-ve duhet të lidhet me strategjitë e balancimit të rrjetit, pasi pa koordinim me operatorët e shpërndarjes, rritet rreziku i disbalancave lokale.

Në përfundim, të gjitha burimet e marra në konsideratë konvergojnë në konkluzionin se rrjeti elektrik po bëhet më kompleks me shtimin e burimeve të rinovueshme dhe stacioneve të karikimit. Një zhvillim i tillë kërkon zgjidhje të qëndrueshme dhe inovative për balancim.

Lidhur me arsyetimin teknik sa më sipër, mbështetur në ENTSO-E “Position Paper on Electric Vehicle Integration”, karikimi i automjeteve elektrike (EV) realizohet përmes disa teknologjive të ndryshme. Edhe pse në vitet e para të zhvillimit të e-mobilitetit prirja ishte për të përmirësuar fuqinë e karikimit me AC (deri në 43 kW në disa modele), aktualisht qasja është kufizimi i karikimit AC në më pak se 22 kW, zakonisht 7 kW me një fazë ose 11 kW me trefazë.

Gjithashtu studimi “Grid Impacts of Electric Vehicle Charging: A Review of Challenges and Mitigation Strategies” (të cilin e gjeni në linkun në vijim: <https://www.mdpi.com/3407866>) evidenton se rritja e përdorimit të automjeteve elektrike (EV) sjell përfitime për industrinë e transportit, por gjithashtu krijon vështirësi për rrjetin e shpërndarjes. Këto ndikime shkaktohen nga rritja e kërkesës për energji elektrike dhe sjelljet e parregullta të karikimit të EV-ve. Kjo mund të ushtrojë presion mbi rrjetet lokale të shpërndarjes gjatë orëve të pikut, për shkak të karikimit të njëkohshëm të shumë automjeteve, duke rezultuar në mbingarkesë të transformatorëve si pasojë e shtimit të kërkesës për energji, disbalancë të frekuencës dhe tensionit, probleme të cilësisë së energjisë dhe bllokim të rrjetit (congestion).

Mbajtja e një profili optimal të tensionit është thelbësore për shpërndarjen efikase të energjisë elektrike. Integrimi i ngarkesave të EV-ve në sistemin ekzistues të shpërndarjes mund të çojë në rënie tensioni në nyje (buses), duke kompromentuar efikasitetin e përgjithshëm të sistemit. Kryesisht, kjo shkaktohet nga shpërndarja e pabarabartë e ngarkesës nëpër nyje. Prania e një numri të madh karikuesish njëfazorë në anën rezidenciale mund të krijojë disbalanca të tensionit nëse nuk shpërndahen siç duhet në një sistem trefazor.

Karikimi intensiv i EV-ve mund të çojë në probleme me faktorin e fuqisë, gjë që rrit humbjet e energjisë dhe ul efikasitetin e sistemit. Problemet e cilësisë së energjisë përfshijnë ngjarje të rëndësishme dhe të papritura që ndikojnë në faktorë të ndryshëm të rrjetit, duke ndikuar në cilësinë e përgjithshme të furnizimit me energji elektrike.

Në vijim, FSHU sh.a. ka bërë me dije se mbështetur në të dhënat e OSSH, stacionet për karikimin e makinave elektrike për periudhën Janar – Gusht 2025 kanë arritur në total 254 ku vetëm për nivelin e tensionit 0.4kV janë të lidhura 219 stacione karikimi.

Konsumi total i parashikuar për vitin 2025 është përllogaritur mbështetur në mesataren e realizuar për periudhën 8-mujore sipas tabelës në vijim:

Viti 2025	8-MUJORI 2025 Kwh	MESATARJA MUJORE Kwh	PARASHIKIMI VJETOR 2025 Kwh
<b>Totali</b>	<b>13,639,052</b>	<b>1,704,882</b>	<b>20,458,579</b>

Kosto vjetore 2025 e parashikuar mbi plan është përllogaritur i mesatarizuar bazuar në realizimin faktik për periudhën 8 mujore 2025 sipas tabelës në vijim:

Përshkrimi	Janar - Gusht 2025 lekë	Kosto mesatare mujore lekë	Kosto totale e parashikuar mbi planin e vitit 2025 lekë
<b>Kosto e disbalancave e realizuar mbi target</b>	109,112,416	13,639,052	163,668,624

Nisur nga këto të dhëna, kosto mesatare mujore e disbalancave mbi plan dhe konsumit mesatar mujor të pikave/satcioneve të karikimit të makinave elektrike arrin në **8 lekë/kWh**. Duke marrë në konsideratë parimet mbi të cilat kryhet përcaktimi i çmimeve si: kosto-reflektuese, transparente dhe jodiskriminuese, vlerësojmë se kjo kosto duhet të shtohet mbi çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 kV meqënëse kosto e disbalancave e planifikuar mbështetur në vlerat e lejuara nga ERE mbulohen nga cmimi **14 lekë/kWh**.

Të ardhurat shtesë që priten të rikuperohen për muajin nëntor - dhjetor evidentohen në tabelën në vijim:

Viti	Sasia totale vjetore e parashikuar sipas konsumit aktual kWh	Cmimi leke/kWh	kosto disbalance mbi ate te parashikuar leke ne nje vit	Kosto mesatare mujore vetem nga disbalanca e kabinave te karikimit 2025	Kosto e realizuar mbi planin per 8 mujorin 2025 nga kjo kategori	Kosto per tu rekuperuar per muaj Nentor + Dhjetor 2025 nga cmimi I ri per kete kategori klientesh leke
2025	20,458,584.00	8.00	163,668,672.00	13,639,056.00	109,112,448.00	27,278,112

Përlllogaritja e koston së realizuar mbi planin tetë -mujor 2025 nga kjo kategori konsumi dhe vlera totale e parashikuar për t'u realizuar deri në fund të vitit 2025, evidentohet në tabelën në vijim:

2025	Kosto vjetore e parashikuar e disbalancave ne total FSHU+FMF	Kosto vjetore e parashikuar per FMF (sasi *0.13 lekë/kWh)	Kosto vjetore e parashikuar per FSHU (diferencë fshu total - fmf)	Kosto e parashikuar per 8 mujorin 2025	Kosto e realizuar mbi planifikimin per 8 mujorin 2025	Kosto totale e realizuar nga disbalancat per 8 mujorin	Rritja ne perqindja
Leke	646,000,000.00	57,590,000.00	588,410,000.00	392,273,333	109,112,448.00	501,385,781.33	21.76%

Meqënëse çmimi prej 22 Lekë/kWh do të aplikohet nga data 1 Nëntor 2025 për të gjithë abonentët familjarë dhe jofamiljarë, të cilët për qëllime të karikimit të një makine elektrike për përdorim vetjak kërkojnë një shtesë fuqie apo pikë lidhje të re me kapacitet të instaluar mbi 11 kW që mund të shfrytëzojnë kapacitetin e lejuar për karikim mjetes elektrike. Ndërkohë që për abonentët me fuqi të instaluar deri në 11 kW FSHU sh.a., kërkon të vijojë aplikimi i çmimeve respektive të miratuara nga ERE.

Sa i takon energjisë elektrike e cila konsumohet në pik nga kjo kategori, sikurse aplikohet në kategoritë e tjera konsumatore, çmimi i shitjes së energjisë aktive në pik do të jetë 15% më i lartë se cmimi i shitjes së energjisë aktive.

Duke qenë se, të dhënat mbi të cilat është kryer ky verësim janë paraprake, ERE në momentin e paraqitjes së aplikimit të rishikimit të çmimeve me pakicë të shoqërisë FSHU sh.a. sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi (ose në varësi të rrethanave edhe me iniciativën e saj), në

rast të konstatimit të ndryshimeve të komponentëve përlllogaritës të të ardhurave të kërkuara, do të kryej korrigjimet përkatëse në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakice tek klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017.

**Përsa më sipër shpjeguar si dhe në mbështetje të neneve 16; 19; 20, gërma “c”; 83 dhe 85 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; VKM-së nr. 456 datë 29.06.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “c” të ‘Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s’, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; “Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 189, datë 23.11.2017, i propozojmë Bordit të ERE-s:**

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për karikimin e makinave elektrike në pikat/stacionet e karikimit me fuqi të instaluar mbi 11 kW, që do të aplikohet nga 1 Nëntor 2025, sipas tabelës bashkëlidhur.

Përshkrimi	Çmimi i energjisë aktive lekë/kWh	*Çmimi i energjisë aktive në pik lekë/kWh
<b>Pika/stacione karikimi të makinave elektrike me fuqi të intaluar mbi 11kW</b>	<b>22</b>	<b>25.3</b>
<i>Orari në pik gjatë të cilit do të aplikohet çmimi për energjinë e konsumuar në pik është:</i>		
<i>Për periudhën 1 Nëntor - 31 Mars ora 18:00 - 22:00</i>		
<i>Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor ora 19:00 - 23:00</i>		

2. Të ardhurat e realizuara mbi/nën ato të lejuara do të korrigjohen nga ERE, në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSSHU)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 189, datë 23.11.2017, në momentin e paraqitjes së aplikimit të rishikimit të çmimeve me pakicë të shoqërisë FSHU sh.a. dhe sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.